



Republika e Kosovës/
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo
Agency of Statistics

Seria 2: Statistikat e Bujqësisë dhe Mjedisit

Anketa e Mbeturinave Komunale 2018



AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS



Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo
Agency of Statistics

Seria 2: Statistikat e Bujqësisë dhe Mjedisit

Anketa e Mbeturinave Komunale 2018



Botuesi: Agjencia e Statistikave së Kosovës (ASK)

Data e botimit: Nëntor 2019

© : Agjencia e Statistikave së Kosovës

Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.

Informata të shumta janë në dispozicion në internet, ku mund të qaseni përmes veb-faqes së ASK-së në internet:

<http://ask.rks-gov.net/>

Parathënie

Agjencia e Statistikave të Kosovës, konkretisht Departamenti i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit, ka organizuar dhe realizuar Anketën e Mbeturinave Komunale për vitin 2018, si anketë e rregullt vjetore.

Qëllimi i kësaj ankete është që të siguroj të dhëna statistikore të qëndrueshme për sektorin e mbeturinave komunale në Kosovë. Rezultatet e prezantuara në këtë publikim ofrojnë një burim të rëndësishëm statistikor për gjendjen e tanishme të këtij sektori.

Metodologjia e aplikuar për realizimin e anketës është në harmoni me rregulloret dhe rekomandimet e BE-së, duke përfshirë edhe Ligjin e Mbeturinave në Kosovë 2005/02/L-30 dhe 2011/04-L-060.

ASK falënderon ekspertin nga GOPA Volker Küchen (AGRUS GmbH, Berlin), për mbështetje profesionale.

Publikimi është përgatitur nga:

Bajrush Qevani, Drejtor DSBM
Haki Kurti, Shef Divizioni i Statistikave të Mjedisit
Flutura Shosholli, Zyrtare e Statistikave të Mjedisit

Sugjerimet, propozimet dhe vërejtjet lidhur me këtë publikim janë të mirëseardhura dhe të dërgohen në:

E- mail: agricultural@ks-gov.net

Nëntor 2019

Kryeshef Ekzekutiv i ASK-së

Isa Krasniqi

Shkurtesat dhe Simbolet

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
KKP	Kompanitë Komunale Publike
DMD	Derë me Derë
BK	Banesa Kolektive
DSBM	Departamenti i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit

Simbolet

Kg/banorë	Kilogram për banorë
kg	Kilogram
t	Tonë

P ë r m b a j t j a

Objektivat, metodologjia e anketës.....	5
Metodologjia.....	5
Procedurat në terren.....	6
Definicioni	6
Rezultatet.....	7
Tabela 1	7
Tabela 2	8
Tabela.3.....	10
Tabela 4.....	12
Aneksi 1 Pyetësoni.....	14

1. Objektivat, metodologjia e anketës

1.1 Objektivat

Objektivi i Anketës së Mbeturine Komunale 2018, ka qenë që të sigurojë të dhëna statistikore për mbeturinat komunale si vijon:

- Gjenerimin e mbeturine komunale dhe
- Trajtimi i mbeturine komunale

Gjithashtu ka pasur për qëllim që të siguroj bazën e monitorimit të mbeturine komunale në të ardhmen në këtë sektor.

1.2 Metodologjia

1.2.1 Korniza e anketës

Në Qershor 2019 janë bërë të gjitha përgatitjet metodologjike për realizimin e AMK 2018 si vijon:

Nga regjistri i bizneseve është nxjerrur lista e bizneseve, përgatitja e pyetësorit dhe udhëzuesit.

Në AMK 2018, janë përfshirë të gjitha kompanitë rajonale dhe të gjithë operatorët ekonomik të cilët merren me menaxhimin e mbeturine komunale. AMK 2018 është përbërë nga 27 bizneseve (duke përfshirë dhe 7 kompanitë rajonale për menaxhimin e mbeturine komunale).

1.2.2 Procedurat në terren

Të dhënat e AMK 2018, janë grumbulluar në periudhën kohore korrik –gusht 2019.

Me qëllim të ngritjes së cilësisë së të dhënave të Anketës së Mbeturive Komunale, për vitin 2018 për dallim prej viteve të kaluara të dhënat janë grumbulluar me anën e një ueb aplikacioni elektronik të përgatitur enkas për realizimin e AMK-së.

Aplikacioni i lartpërmendur është përgatitur si produkti i pilot projektit të mbeturive PP.5.6 IPA 2015.

Të dhënat nga terreni janë grumbulluar nga zyrtarët e ASK-së, në mënyrë elektronike me anë të tabletit. Gjatë periudhës së grumbullimit të të dhënave menaxherët e kompanive për menaxhimin e mbeturive komunale njëkohësisht janë njoftuar me ueb aplikacionin dhe mënyrat e përdorimit të tij.

Kontrollimi i cilësisë së të dhënave është bërë nga stafi i divizionit të statistikave të mjedisit në ASK.Ndërsa vlefshmëria e të dhënave është bërë në bashkëpunim me ekspertin nga GOPA.

2. Definicioni

Mbeturinat Komunale - janë mbeturina nga amvisëritë, po ashtu edhe mbeturina nga aktivitetet tjera të cilat për shkak të përbërjes dhe natyrës së tyre, janë të ngjashme me ato të amvisërisë.

3. REZULTATET E ANKETËS SË MBETURINAVE KOMUNALE 2018

Tabela 1: Mbeturinat komunale të grumbulluara për vitin 2018

Vendi i grumbullimit	Sasia e grumbulluar	Popullsia ¹	Mbeturina të grumbulluara	
			kg/banorë/vit	kg/banorë/ditë
Njësia	1000/tonë			
Prishtina dhe regjioni ²	110	493.058	223	0,61
Regjionet tjera	297	1.302.608	228	0,62
Gjithsej Kosova	407	1.795.666	227	0,62

Në Kosovë për vitin 2018 janë grumbulluar gjithsej 407 mijë tonë mbeturina komunale.

Të dhënat e vitit 2018 tregojnë se mesatarja e mbeturinave komunale të grumbulluara në Kosovë ka qenë 227 kg për banorë në vit ose 0.62 kg mbeturina për banorë në ditë.

Në Prishtinë dhe regjionin e sajë grumbullimi i mbeturinave komunale ka qenë 0.61 kg në ditë për banorë.

Në regjionet tjera të Kosovës sasia e mbeturinave komunale të gjeneruara për banorë në ditë ka qenë 0.62 kg (shiko tabelën 1).

Në vitin 2018, nga sistemi i grumbullimit të mbeturinave komunale kanë qenë të mbuluara 76% e ekonomive familjare.

1 _____

ASK, Vlerësimi i Popullsisë së Kosovës 2018 (publikuar qershor 2019), sipas komunave.

2 _____

Prishtina, Obiliqi, Gllgoc, Fushë Kosova, Lipjani, Graçanica, Podujeva.

Tabela 2. Gjithsej sasia e mbeturinave komunale të grumbulluara sipas regjioneve për vitet 2012-2018.

Vitet	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Njësia	në 1000 ton						
Prishtina dhe regjioni	249	255	95	105	105	115	110
Regjionet tjera	358	320	152	214	289	294	297
Kosova gjithsej	607	575	247	319	395	409	407
Njësia	në kg/banorë,v						
Prishtina dhe regjioni	515	517	193	214	221	235	223
Regjionet tjera	269	242	119	163	224	225	228
Kosova gjithsej	334	317	140	177	223	228	227
Njësia	në kg/banorë,d						
Prishtina dhe regjioni	1.41	1.41	0.50	0.60	0.60	0.60	0.61
Regjionet tjera	0.70	0.66	0.30	0.50	0.61	0.61	0.62
Kosova gjithsej	0.90	0.86	0.40	0.50	0.61	0.61	0.62

Të dhënat e mbeturinave komunale të grumbulluara sipas viteve 2012- 2018, tregojnë se mbeturinat e grumbulluara sipas vendit të grumbullimit kanë dallime të theksuara sasiore nga viti në vit, kjo dukuri vërehet sidomos në vitet 2012-2014. Gjithashtu të dhënat e grumbulluara për banorë në kg/ vit, tregojnë se dallime më të theksuara sasiore janë vërejtur nga vitet 2012-2014. Ndërsa për vitet në vazhdim nuk vërehet ndonjë diferencë e madhe. Gjithsej sasia e mbeturinave komunale të grumbulluara për vitin 2018 krahasuar me vitin 2017 ka qenë për 1% më e ulët.

3

Që nga viti 2010, sasia e mbeturinave komunale për banorë është llogaritur në bazë të të dhënave të Regjistrimit të Popullsisë 2011 (për vitin 2010 të dhëna preliminare, ndërsa për vitin 2011, të dhëna përfundimtare). Rritja e lartë e mbeturinave komunale për banorë nga vitit 2009- 2010 është rezultat i ndikuar kryesisht nga të dhënat më numër më të ulët të popullsisë që nga viti 2011.

Grafiku 1. Grumbullimi i mbeturinave komunle sipas regjioneve për vitet 2017/2018.




Tabela 3. Gjithsej sasia e mbeturinave komunale të grumbulluara siaps regjioneve vitin 2018.

Vendi i grumbullimit	Sasia e grumbulluar 1000/Tonë	Popullsia	Mbeturina të grumbulluara	
			kg/banorë/vit	kg/banorë/ditë
Njësia				
Prishtinë	110	493.058	223	0,61
Ferizaj	41	182.881	223	0,61
Gjakovë	30	201.303	147	0,40
Gjilan	33	164.007	203	0,56
Mitrovicë	66	224.929	292	0,80
Pejë	53	180.097	295	0,81
Prizren	74	349.391	213	0,58
Gjithsej Kosova	407	1.795.666	227	0,62

Në tabelën 3 janë paraqitur të dhënat e mbeturinave komunale të grumbulluara sipas regjioneve për vitin 2018, ku sipas tabelës shihet se numri më madh i mbeturinave të grumbulluara ka qenë në regjionin e Prishtinës, 110 mijë tonë në vit, dhe 223 kg për banorë në vit. Ndërsa sasia më e vogël e mbeturinave të grumbulluara ka qenë në regjionin e Gjakovës 30 mijë tonë në vitë, ndërsa sasia e mbeturinave të grumbulluara për banorë në vitë ka qenë 147 kg.

Grafiku 2: Grumbullimi i mbeturinave komunale për banorë sipas regjioneve për vitin 2018.





Tabela 4: Mbeturinat komunale të deponuara në deponitë sanitare dhe josanitare për vitin 2018.

Deponitë	2018
	1000/tonë
Mirash (Prishtinë)	126
Ferizaj (Ferizaj)	22
Velekincë (Gjilan)	44
Gërmovë (Mitrovicë)	62
Sferk (Pejë)	49
Landovicë (Prizren)	96
Dragash (Prizren)	6
Tjera (Dumnicë, Podujevë, Tupeq- Istog, Trokone)	13
Deponitë josanitare	8
Gjithsej:	426

Gjithsej sasia e mbeturinave të deponuara në vitin 2018 në deponitë sanitare dhe josaniatre ka qenë 426 mijë tonë (shiko tabelën 4).

Të dhënat e këtyre deponive tregojnë se sasia më e madhe e mbeturinave të deponuara ka qenë në deponin e Mirashit me 126 mijë tonë mbeturina të deponuara në vitë, ndërsa saisa më e vogël e mbeturinave të deponuara ka qenë në deponin në Dragash me vetëm 6 mijë tonë mbeturina të deponuara në vitë, ndërsa gjithsej sasia e mbeturinave të depunuara në deponitë josanitare ka qene 8 mijë tonë.

Grafiku 3: Mbeturinat komunale të grumbulluara në deponitë e Kosovës në vitin 2018.



Aneks 1 Pyetësi

Agjencia e Statistikave të Kosovës përshkrim i shkurtër

Agjencia e Statistikave të Kosovës, është institucion profesional, i cili vepron që nga viti 1948 dhe ka kaluar disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe. Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën profesionale, si i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës dhe donatorë për projekte të veçanta.

Agjencia e Statistikave të Kosovës vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011. Plani zhvillimor strategjik 2009-2013 është në implementim afatmesëm për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

Misioni i Agjencionit, është që të përmbush nevojat e përdoruesve me të dhëna statistikore objektive dhe analiza të rregullta në mënyrë që të përkrah departamentet qeveritare, t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

Adresa: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Rr."Zenel Salihu" Nr.4, Prishtinë

Telefonat: +383 (0) 31 129

Kryeshefi ekzekutiv : +383 (0) 38 200 31 112

Fax: +383 (0) 38 235 033

E-mail: infoask@rks-gov.net

Ueb-faqe: <http://ask.rks-gov.net/>